




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PËRMBARIMIT "A.D.R"

Nr.23/3 prot.

Datë 18. 06. 2018

URDHËR
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE



Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Biznesit

Unë, Dorian Zazani, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit nr. akti 3714 dt. 24.04.2018, lëshuar prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë urdhër duke regjistruar pranë kësaj zyre dosjen me :

Kreditor : Shoqëria "Gent Alba" sh.p.k

Debitor : Shoqëria "Integrated Technology Services" sh.p.k me NUIS L02302032C;

Objekt : Detyrim monetar;

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit lajmërimin (në referim të neneve 517 dhe 518 të K. Pr. Civile) për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit i lartpërmendur,
KONSTATOJ se :

Debitori ka marrë njoftimin e lajmërimit për ekzekutimin vullnetar dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi. Në këto kushte, në referim të nenit 527 të K. Pr. Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit në masën që dotë jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Për sa më sipër, në referim të neneve 519 dhe 527 të K. Pr. Civile,

URDHËROJ :

Vendosjen e sekuestros konservative mbi kuotat e debitorit :

- "Integrated Technology Services" sh.p.k me NUIS L02302032C.
- Qendra e Kombëtare e biznesit, të bëjë verifikimin dhe bllokimin e kuotave të debitorit Integrated Technology Services me administrator Z. Klodian Zoto si dhe të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave duke ndaluar tjetërsimin ose disponimin e tyre dhe moskryerjen e asnjë lloj veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar.
- Dokumentacioni do të qendrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë nga ana jonë.
- Për veprimet tuaja më informoni brënda afateve ligjore.

Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e këtij urdhëri, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

PËRMBARUESI GJYQËSOR

DORIAN V. ZAZANI

